



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:264159

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05467735

**C.nr.1076/21**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri me Bashkëpunëtorin Profesional Visar Morina, në çështjen juridike të paditëseve Sh. H.dhe A. M. që të dyja nga Malisheva mësimdhënëse në SHFMU “I. M.” në Malishevë, të cilat me autorizim i përfaqëson Av. Zahir Hamza rr. “Garibaldi” Hy.17, nr.5-Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim për shujta ditore, vlera e kontestit **460.00 euro**, jashtë seancës gjyqësore me datë **18.03.2024** mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**për shkak të pa dëgjueshmërisë/mosbindjes**

- I. **APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditëseve Sh. H.dhe A. M. nga Komuna e Malishevës
- II. **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëseve t’ua paguaj shumën e përgjithshme prej **460.00 euro** (katërqind e gjashtëdhjetë) euro dhe atë për secilën paditëse shumat si në vijim:
  - a) Paditëses Sh. H. në emër të shujtës ditore të përlogaritur për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 04.10.2021, për gjithsejtë 115 ditë pune t’ia paguaj nga dy (2) euro në ditë ose shumën prej 230.00 euro dhe
  - b) Paditëses A. M. në emër të shujtës ditore të përlogaritur për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 04.10.2021, për gjithsejtë 115 ditë pune t’ia paguaj nga dy (dy) euro në ditë ose shumën prej 230.00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% që nga data e paraqitjes së padisë me datë 11.11.2021 dhe në afat prej 7 ditësh plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. **OBLIGOHET** e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 137.00 € dhe atë në emër të parashtrimit të padisë, shumën prej 117.00 euro dhe në emër të taksës shumën prej 20.00 euro, ndërsa REFUZOHET pjesa tjetër e shpenzimeve të procedurës së paditësit përtej kësaj shume.

## **A r s y e t i m**

### *Pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Paditëset Sh. H.dhe A. M. nga Malisheva, përmes të autorizuarit të tyre av. Zahir Hamza nga Prishtina, në këtë gjykatë kanë parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave ditore, duke pretenduar se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit e datës 18.04.2017, të gjithë punonjësve të arsimit iu njihet e drejta e kompensimit për shujtat ditore.

Kanë shtuar se paditëset janë të punësuar tek e paditura në bazë të kontratës së punës në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët SHFMU “I.M.” në Malishevë dhe ato i plotësojnë kushtet e përfitimit të shujtës ditore sipas kushteve të parapara me Kontratën Kolektive të Arsimit, andaj kanë kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia dhe të detyrohet komuna e Malishevës që në emër të kompensimit për shujta, t’ia paguaj për secilën paditëse nga 370.00 euro për 185 ditë pune.

I autorizuari i paditëseve përmes parashtrësës ka precizuar padinë dhe tani për secilën paditëse ka kërkuar nga 230.00 euro për 115 ditë pune, për periudhën kohore 01.01.2021 deri 04.10.2021 ose për dy paditëse shumë e përgjithshme prej 460.00 euro me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 312 euro dhe për taksë gjyqësore shumë prej 20 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi të datës 29.09.2023, e cila është pranuar me datë 06.10.2023, mirëpo e njëjta nuk ka parashtruar përgjigje në padi.

### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi provat dhe atë: Vërtetimin nr.... të datës 04.10.2021 lidhur me marrëdhënien në punë dhe për ditët e punës për paditësen Sh. H. dhe Vërtetimin nr.... të datës 04.10.2021 lidhur me marrëdhënien në punë dhe për ditët e punës për paditësen A. M., të dyja këto vërtetime të lëshuara nga UD-Drejtorit të SHFMU “I. M.” në M..

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditëset Sh. H. dhe A. M. janë në marrëdhënie pune tek e paditura, më konkretisht në marrëdhënie pune në SHFMU “I.M.” në Malishevë dhe prej datës 01.01.2021 deri me datën 04.10.2021, secila prej tyre i ka gjithsejtë nga 115 ditë pune, dhe ky fakt dëshmohet me vërtetimet nr.... të datës 04.10.2021 për Sh. H., dhe nr.... të datës 04.10.2021 për paditësen A.M..

Kontestuese ka qenë nëse paditëseve iu takon e drejta e kompensimit të mjeteve në emër të shujtave për ditët sa kanë punuar në SHFMU “I. M.” në Malishevë.

### *Baza ligjore*

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 150 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëseve është e themeltë dhe si e tillë duhet aprovuar.

Dokumentet (vërtetimet) e lartcekura, gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1 të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, andaj meqë këto dokumente janë të lëshuara nga vetë e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, janë prova me të cilat vërtetohen faktet lidhur me marrëdhënien e punës dhe ditët e punës për periudhën e cekur si në dispozitiv.

Sipas nenit 8 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve: *“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”* ndërsa në dispozitat e nenit 245 par.1 të LMD-së është paraparë se: *“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”*.

Bazuar në Ligjin e Punës Nr.03/L-212, në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*, lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, ku me nenin 3 paragrafin 2 përcaktohet se: *“I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”*, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditëset kanë qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, lidhur me kërkesën për kompensimin e shujtave, u vendos që të njëjtën ta aprovoj tërësisht.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruara në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, të cilat kanë hyrë në fuqi me datat 18.04.2017 dhe 22.01.2021.

Sipas Mendimit Juridik për Shpërblimin Jubilar të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr.40/2023 të datë 27.02.2023, në Pikën e IV të këtij mendimi juridik parashikohet se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovës e datës 18.04.2017 aplikohet për periudhën prej 18.04.2017 deri më 21.01.2021, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur me datë 22.01.2021 aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri me datë 21.11.2022 kur edhe është shkëputur nga MASHT.

Konform dispozitave të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2021 dhe 22.01.2021 të lidhura mes Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, në nenin 35 paragrafi 7 përcaktohet se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*, andaj duke u nisur nga kjo, gjykata vlerëson se paditëseve u takon e drejta e kompensimit për shujtat ditore gjatë punës për ditët e pranisë në punë, përkatësisht për periudhën 01.01.2021 deri më 04.10.2021, pra për 115 ditë pune të llogaritura nga dy (2) euro për një ditë pune (115 ditë pune x 2 euro = 230 euro për secilën paditëse).

### Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Meqenëse nga parashtrësia e padisë u konstatua se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër faktit se e paditura vetë i ka lëshuar vërtetimet mbi marrëdhënien në punë dhe ditët e punës lidhur me kompensimin për shujta ditore, për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme dhe si të tilla janë të besueshme

Siç u cek edhe më lart, në kuptim të neneve 394 dhe 395 të Ligjit të procedurës Kontestimore, gjykata të paditurës i ka dërguar padinë, provat materiale dhe aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi, por e njëjta nuk ka kthyer përgjigje.

Në fletë dërgesën për dorëzim personal konstatohet se me datë 06.10.2023, e paditura gjegjësisht avokati publik i saj, personalisht e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi të datës 29.09.2023, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjigjes në padi, i njëjti nuk ka kthyer përgjigje në padi, andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 150 par.1 pika (a), (b) dhe (c) të LPK-së, gjykata mori aktgjykim për shkak të pa-dëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet si më poshtë:

- a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia, provat materiale dhe thirrja-Aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi,
- b) Themelësia e kërkesë padisë rezulton nga faktet e treguar në padi dhe
- c) Faktet mbi të cilat mbështet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit dhe duke e llogaritur kamatën ligjore prej 8 %, bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së nga dita e parashtrimit të padisë (11.11.2021) dhe bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mori konform nenit 453.1 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se: *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t'i shpërblehen palës,*

*gjkata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullores për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, e cila rregullore përcakton se përpilimi i padisë në kontestet e vlerës së vogël (nën 500.00 euro, siç është në rastin konkret), për dy paditës është në shumën prej 117.00 euro, ashtu që vendosi që paditëseve t’ua njoh shpenzimet e procedurës duke detyruar të paditurën që t’ia paguajë shumën prej 117.00 euro në emër të parashtrimit të padisë, dhe shumën prej 20.00 euro në emër të taksës gjyqësore, ndërsa e ka refuzuar kërkesën përtej kësaj shume.*

Andaj, në një gjendje të këtillë dhe mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.1076/21, datë 18.03.2024**

**Gj y q t a r i**  
**Petrit Curri**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.